



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data: 18.05.2020]

Për: **“4 S” SHPK**

Adresa: Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Çajupi, godine nje kateshe, mbrapa shkolles Liri Kazazi nr 199.

* * *

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e Hapur”- Mallra - Marrëveshje kuadër me disa operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë, për autoritetet kontraktore të qarkut Kukes” ndarë në 6 (gjashtë) Lote, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 20,696,389 (njëzetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë nëntë) lekë pa TVSH, me numër reference: REF-53877-03-11-2020.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës së **Lotit I me numër reference REF-53880-03-11-2020, “Blerje bukë gruri dhe simite”, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 2,266,111 (dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 24 (njëzetë e katër) muaj të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.**

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 17.03.2020, Nr.12.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Për lotin I: Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1) **“4 S” SHPK**

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: **2,160,000** (dy milion e njëqindë e gjashtëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

L64425401K

numri i NIPT-it

2) **“KADRA” SHPK**

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: **0** (zero) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

K31321008J

numri i NIPT-it

3) **“LUAN RRUSHI” SHPK**

Emri i plotë i shoqërisë

L32615801G

numri i NIPT-it

Vlera: **0** (zero) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

- 4) **“M.C.CATERING” SHPK** **K72218022J**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **1,998,000** (një milion e nëntëqindë e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

- 5) **“NIKA” SHPK** **J76705047U**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **2,160,000** (dy milion e njëqindë e gjashtëdhjetë mijë)lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë).

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- 1) **“KADRA” SHPK** **K31321008J**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
- 2) **“LUAN RRUSHI” SHPK** **L32615801G**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
- 3) **“M.C.CATERING” SHPK** **K72218022J**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
- 4) **“NIKA” SHPK** **J76705047U**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Arsyet e skualifikimit për “KADRA” SHPK

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike si dhe asnjë prej dokumenteve të kërkuara në DT.

Arsyet e skualifikimit për “LUAN RRUSHI” SHPK

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike si dhe asnjë prej dokumenteve të kërkuara në DT

Arsyet e skualifikimit për “M.C.CATERING” SHPK

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2 të Kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomike, pasi nuk arriti të paraqesë, Leje Mjedisi të tipit C (kodi III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar).
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të Kapacitetit teknik, pasi nuk arriti të vertetojë se ka në pronësi ose në përdorim 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 30 m2. Kontrata e furnizimit me nr. Repertori; 433, nr.koleksioni 96 e datës 20/03/2020 e lidhur me subjektin “Eraldo - 2013” shpk, kur ky i fundit nuk është deklaruar si nënkontraktor nga ofertuesi si dhe nuk ka as marrëveshje bashkëpunimi të përkohshëm të operatorëve ekonomik midis ofertuesit

“M.C Catering” SHPK dhe “Eraldo - 2013” shpk nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për përmbushjen e kriterit. Gjithashtu sqarojmë se ambjenti për të cilin janë paraqitur dokumentet; Akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi disponohet nga “Eraldo - 2013” shpk dhe jo nga ofertuesi “M.C Catering” SHPK.

- Akt marrëveshja me nr. Repertori; 434, nr.koleksioni 97 e datës 20/03/2020 e lidhur me subjektin “Ismet Darsi” pf, kur ky i fundit nuk është deklaruar si nënkontraktor nga ofertuesi si dhe nuk ka as marrëveshje bashkëpunimi të përkohshëm të operatorëve ekonomik midis ofertuesit “M.C Catering” SHPK dhe “Ismet Darsi” pf nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për përmbushjen e kriterit. Gjithashtu sqarojmë se ambjenti për të cilin janë paraqitur dokumentet; Akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi disponohet nga “Ismet Darsi” pf dhe jo nga ofertuesi “M.C Catering” SHPK.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklarata ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret

Arsyet e skualifikimit për “NIKA” SHPK

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 3 të Kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomike, pasi certifikata ISO 9001 e paraqitur nga ana e tij është lëshuar për qellim “prodhim dhe shpërndarje ushqimi” (shërbim katering) i ndryshëm nga objekti i procedurës “blerje ushqimesh”
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të Kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomike, pasi certifikata ISO 22000 ose ekuivalent e paraqitur nga ana e tij është lëshuar për qellim “prodhim dhe shpërndarje ushqimi” (shërbim katering) i ndryshëm nga objekti i procedurës “blerje ushqimesh”.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 5 të Kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomike, pasi certifikata ISO 14001 ose ekuivalent e paraqitur nga ana e tij është lëshuar për qellim “prodhim dhe shpërndarje ushqimi” (shërbim katering) i ndryshëm nga objekti i procedurës “blerje ushqimesh”.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 germa b të Kapacitetit teknik, pasi akt miratimi higjeno – sanitar për ambientin e paraqitur është lëshuar me qellim shërbim katering dhe jo prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 7 të Kapacitetit teknik, pasi **Raport/ Fletë Analizë Fiziko-Kimike** e lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, është përpara 30 ditëve nga data e zhvillimit të procedurës.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomik të suksesshëm:

“4 S” SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: **2,160,000** (dy milion e njëqindë e gjashtëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

L64425401K

numri i NIPT-it

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.05.2020

Ankesa: Jo.

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM